# DËSHMI ARKIVI

**A-447710**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pritet vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, policia largon djalin e Thaçit nga hyrja e gjykatës! Gazetarja jep detajet - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/pritet-vendimi-per-ish-kreret-e-uck-mbeshtetes-dhe-familjare-mblidhen-para-gjykates-speciale/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 06:36:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 06:34:42 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2db392c8331c45adda4176f46b44506bf75b40ffd1983eae2b00b0150219c305` |
| TEKSTI | `dafab0ae466c6fc502a19f410438a9b0307cb73d98b62a1c710c177fac7c6b3a` |
| PAMJA | `c340ab8ca5e1c8a485d2ce6b0a21505152dacee7bc6249161a151ea04ed10cfa` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `03c597ffb76ef93c412c78157baabeb9416eb704562b35f8e9b720996a134e66` |
| E MËPARSHMJA | `c852deffe459e9086505750f889ffe84a2dc12e5892cb3dcd8329f8da7ff79d4` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/03c597ffb76ef93c412c78157baabeb9416eb704562b35f8e9b720996a134e66`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | RAJONI

# Pritet vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, policia largon djalin e Thaçit nga hyrja e gjykatës! Gazetarja jep detajet

16 Shtator 2026 | 08:34

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Këtë të mërkurë pritet të jepet vendimi në Gjykatën Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së. Lidhur me këtë vendim të rëndësishëm, dhjetëra persona kanë udhëtuar nga vende të ndryshme të botës për të shprehur mbështetjen e tyre ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Të pranishëm janë edhe familjarë të ish-krerëve të UÇK-së mes tyre edhe djali i Hashim Thaçit, Endrit Thaçi. Gjithashtu në ambientet e jashtme të Gjykatës Speciale pati një incident ku të pranishmit kanë kërkuar që një gazetar nga Kosova të largohet nga vendi i ngjarjes.

Gazetarja e Euronews Albania, Esmeralda Mulaj ka bërë me dije se mbështetësit kanë kërkuar që gazetari të largohet për shkak të qëndrimeve që ka mbajtur më parë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Për të shmangur ndonjë përshkallëzim, djali i Thaçit është spostuar deri sa të jetë e mundur futja në ambientet e Gjykatës Speciale.

“O Hashim ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke”, po thërrasin një zëri mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së.

Shiko në:

## LAJMI I FUNDIT

08:37 **Rama në ceremoninë e hapjes së Konsullatës Shqiptare në Napoli: Italia është ‘alter egoja’ jonë evropiane**

08:23 **Lionel Messi thirret nga Argjentina për të bërë paraqitjen e lamtumirës në miqësoren kundër Benin**

08:23 **Arabia Saudite shkatërron dronin e rebelëve Huthi pranë Mekës**

08:15 **Tre të vdekur nga rrëzimi i helikopterit të NBC-së gjatë raportimit live në Los Angeles (VIDEO)**

08:12 **Drejtori ekzekutiv i Anthropic ripërsërit thirrjen për ngadalësim të IA-së, Nvidia kërkon përshpejtim**

08:04 **“Unë s’jam e lirë, pa lirinë tënde, gjysh” , mbesa e vogël puth portretin e Jakup Krasniqit para vendimit në Hagë**

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

**“Unë s’jam e lirë, pa lirinë tënde, gjysh” , mbesa e vogël puth portretin e Jakup Krasniqit para vendimit në Hagë**

Moment emocionues, vajza e Jakup Krasniqi publikon videon me të bijën e vogël që puth protretin e gjyshit, “Të pres me mall e dashur”. Një...

08:04 | 16/09/2026



KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

### “Presim lirimin”, gjithë sytë e shqiptarëve nga Haga, 3 orë nga vendimi për ish-krerët e UÇK-së

Pas rreth gjashtë vitesh pritjeje, sot vjen momenti kur çështja ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së hyn në një pikë vendimtare. Në Hagë pritet të nisë...

07:39 | 16/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

### “Zjarret e lirisë” ndizen në Prishtinë, qytetarët presin verdiktin për ish-krerët e UÇK-së

Gazetari i Euronews në Kosovë, Xhemajl Rexha, raportoi për emisionin “Now me Erla Mëhillin” nga sheshi “Skënderbej” në qendër të Prishtinës, 12 orë para vendimit...

22:30 | 15/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.